


REPUBLIKA E KOSOVË
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
 ZYRA E KRYEMINISTRIT
 KANCELARIJA PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
 ZYRA LIGJORE - PRAVNA KANCELARIJA - LEGAL OFFICE
 Nr. 2624/2
 Pe
 18.11.2022



REPUBLIKA E KOSOVË
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
 ZYRA E KRYEMINISTRIT
 KANCELARIJA PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
 ZYRA LIGJORE - PRAVNA KANCELARIJA - LEGAL OFFICE
 1042
 11.11.2022

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit
Kancelarija Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra Ligjore - Pravna Kancelarija - Legal Office

REFERENCË:	2624-2-2022
DATË:	18.11.2022
PËR/ZA/TO:	Naim Shala, Drejtor i Departamentit Ligjor / Ministria e Punëve të Brendshme
CC:	Fahrije Tërnavë, Sekretare e Përgjithshëm / Ministria e Punëve të Brendshme
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arben Krasniqi, zv. Sekretar i Përgjithshëm / Zyra e Kryeministrit Mentor Borovci, Drejtor i Zyrës Ligjore / Zyra e Kryeministrit
NGA/OD/FROM:	Labinote Kashtanjeva, / Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Çështje Ligjore të BE-së / Zyra Ligjore / Zyra e Kryeministrit
TEMA/SUBJEKTI/SUBJECT:	Shkresa përcjellëse për Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me <i>acquis</i> të BE-së për <i>Projektligjin për zyrtarët publik</i>

I nderuar z. Shala,

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Rregulloren nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenin 8 par 2.16 si dhe nenin 12 par 1.1 të Rregullores (ZKM) Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Zyrën e Kryeministrit, ju përcjellim Opinionin Ligjor të Përputhshmërisë me *acquis* të BE-së për *Projektligjin për zyrtarët publik*.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit
Kancelaria Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra Ligjore - Pravna Kancelaria - Legal Office

OPINIONI LIGJOR I PËRPUTHSHMËRISË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

18.11.2022

Departamenti Ligjor në Ministrinë e Punëve të Brendshme me datë 15 nëntor 2022, bazuar në Nenin 7, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Nenit 13 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafin 3 dhe paragrafin 4 nën paragrafin 4.19 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ka dorëzuar për shqyrtim në Divizionin e të Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit, *Projektligjin për zyrtarët publik.*¹

1. SUBJEKTI

Opinion ligjor për përputhshmërinë e *Projektligjin për zyrtarët publik me acquis* të BE-së.²

2. DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA

Në kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për opinion ligjor të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së janë dërguar drafti përfundimtar i projekt aktit (vetëm në gjuhën shqipe), deklarata e përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës me *acquis* të BE-së (shqip, serbisht, anglisht).

3. PREAMBULA

Në pajtim me nenin 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 3 nën paragrafi 1.3, Nenit 13 paragrafi 6, Neni 21 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar dhe nenit 30 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, Divizioni i së Drejtës së BE-së, në Zyrën e Kryeministrit, bazuar në fushëveprimin e kompetencave të tij, më datë 18 nëntor 2022 lëshon këtë:

¹ Emri i Projektligjit është transkriptuar saktësisht siç është pranuar nga kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

² Kërkesa për lëshimin e Opinionit Ligjor është kërkuar të procedohet në mënyrë urgjente nga organi propozues, andaj, nuk marrim përgjegjësi për lëshimet eventuale për arsye të kohës shumë të shkurtër për shqyrtim të hollësishtëm përmbajtjesor.

4. OPINION LIGJOR PËR PËRPUTHSHMËRINË ME LEGJISLACIONIN E BE-SË

Kërkesa për opinionin ligjor me *acquis* të BE-së është dërguar në kopje fizike dhe elektronike më datën 15 nëntor 2022 me nr. protokollit 2624.

5. HYRJE

Qëllimi i këtij Projektligji ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it /it publike në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitave, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it /it publike në institucionet e Republikës së Kosovës.³ Projektligji gjithësej ka 105 nene.

6. PËRMBLEDHJA E AKTEVE TË BE-SË QË RREGULLOJNË FUSHËN E PROJEKT AKTIT

Acquis primare në kuadër politikave sociale dhe të drejtës së punës përcakton "...nxitjen e punësimit, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të punës, në mënyrë që të mundësohet harmonizimi i tyre gjatë ruajtjes së përmirësimit, mbrojtja e duhur sociale, dialogu midis drejtuesve dhe punonjësve, zhvillimi i burimeve njerëzore me qëllim ruajtjen në periudhë afatgjatë të punësimit të lartë dhe luftën kundër përjashtimit social."⁴ *Acquis* gjithashtu, përcakton bashkërendimin në veçanti në çështjet e lidhura me: marrëdhëniet e punës, legjislacionin e punës dhe kushtet e punës, formimin profesional bazë dhe të avancuar, sigurimet shoqërore, parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, higjienën në punë, të drejtën e shoqërimit dhe negociatave kolektive midis punëdhënësve dhe punonjësve.⁵ Po ashtu, *acquis* siguron edhe parimin e pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë.⁶ *Acquis* përcakton që "pagë" do të thotë rroga e zakonshme bazë ose minimale dhe çdo lloj tjetër kundërvlefte, në para ose në natyrë, që punëdhënësi i jep punonjësit drejtpërdrejt ose tërthorazi, nisur nga marrëdhëniet e punës.⁷ Në kuadër të zbatimit të efektshëm të *acquis*, Shteteve Anëtare iu kërkohet si në vijim:

Neni 197

1. Zbatimi i efektshëm i të drejtës së Bashkimit nga Shtetet Anëtare, i cili është thelbësor për funksionimin e duhur të Bashkimit, konsiderohet si çështje me interes të përbashkët.
2. Bashkimi mund të mbështesë përpjekjet e Shteteve Anëtare për përmirësimin e kapacitetit të tyre administrativ për të zbatuar të drejtën e Bashkimit. Një veprim i tillë mund të përfshijë mundësimin e shkëmbimit të informacionit dhe të nëpunësve civilë si edhe mbështetjen e skemave të trajnimit. Asnjë Shtet Anëtar nuk është i detyruar të përfitojë një mbështetje të tillë. Parlamenti Evropian dhe Këshilli, përmes rregulloreve sipas procedurës së zakonshme legjislative, vendosin masat e nevojshme për këtë qëllim, duke përjashtuar harmonizimin e akteve ligjore dhe nënligjore të Shteteve Anëtare.
3. Ky nen nuk i cenon detyrimet e Shteteve Anëtare për të zbatuar të drejtën e Bashkimit apo të drejtat dhe detyrimet e Komisionit. Ai nuk i cenon dispozitat e tjera të Traktateve të cilat

³ Neni 1 i Projektligjit

⁴ *Shih* neni 151 para. 1 TFBE, i qasshëm përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012E%2FTXT>.

⁵ *Aty*, neni 156.

⁶ *Aty*, neni 157 para. 1.

⁷ *Aty*, para. 2.

parashikojnë bashkëpunimin administrativ midis Shteteve Anëtare dhe midis tyre dhe Bashkimit.

Në kuadër të së drejtës së punës, *acquis* përcakton edhe të drejtën e miradministrimit. Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian (pjesë integrale e TFBE-së) lidhur me miradministrimin përcakton:

Neni 41

E drejta e miradministrimit

1. Çdo person ka të drejtë që çështjet e tij ose të saj të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda afateve kohore të arsyeshme nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit.
2. Kjo e drejtë përfshin:

(a) të drejtën e çdo personi që të dëgjohet përpara se kundër tij të merren masa që do ta cenonin atë;

(b) të drejtën e çdo personi për të parë dosjen e vet, duke respektuar interesat legjitime të ruajtjes së fshehtësisë së informacionit si edhe të sekretit profesional dhe tregtar;

(c) detyrimin e administratës që të argumentojë vendimet e marra.

3. Çdo person ka të drejtën që t'i kërkojë Bashkimit zhdëmtim për dëmet që mund të jenë shkaktuar prej institucioneve apo prej nëpunësve të tij gjatë ushtrimit të detyrave, në përputhje me parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për legjislacionet e Shteteve Anëtare.

4. Çdo person mund t'u drejtohet me shkrim institucioneve të Bashkimit në një prej gjuhëve të Traktateve dhe është e detyrueshme që të marrë përgjigje në po atë gjuhë.

Praktika gjyqësore e GJDBE-së që lidhet me fushën e miradministrimit ka zhvilluar parime të përgjithshme.⁸ E drejta për administrim të mirë është një e drejtë themelore procedurale. Ajo synon të përmbushë angazhimin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, si një nga vlerat e tij themeluese.⁹ Parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të GJDBE-së bëjnë dallimin në mes të paanshmërisë objektive dhe subjektive. Paanshmëria objektive lidhet me paanshmërinë e institucionit të përfshirë.¹⁰

⁸ *Shih*, Case C- 439/ 11, *Ziegler*, EU:C:2013:513, para 155.

⁹ Neni 2 i TFBE-së përcakton "*Bashkimi ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, Shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkaşin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare në një shoqëri në të cilën mbisundon pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave.*"

¹⁰ *Shih* Case C- 439/ 11, *Ziegler*, EU:C:2013:513, para 155. Neni 41 i Kartës përcakton se çdo person ka të drejtë, ndër të tjera, që punët e tij/saj të trajtohen në mënyrë të paanshme nga institucionet e Bashkimit Evropian. Kjo kërkesë për paanshmëri përfshin, nga njëra anë, paanshmërinë subjektive, ku asnjë anëtar i institucionit në fjalë që është përgjegjës për çështjen nuk mund të tregojë njëanshmëri ose paragjykim personal, dhe, nga ana tjetër, paanshmëri objektive, ku duhet të ketë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim sa i përket ansshmërisë nga ana e institucionit në fjalë (*shih*, për analogji, rastet e bashkuara C 341/06 P dhe C-342/06 P *Chronopost and La Poste v UFEX and Others* [2008] ECR I-4777, paragrafi 54, dhe Case C-308/07 P *Gorostiaga Atxalandabaso v Parliament* [2009] ECR I-1059, paragrafi 46).

Paanshmëria subjektive lidhet me anëtarin brenda institucionit në fjalë, i cili është përgjegjës për një çështje, të mos tregojë paragjykime ose paragjykime personale.¹¹

Rijedhimisht, rregullimi fushëveprimit të shërbyesve civil të institucioneve të BE-së dhe shërbyeseve civil të administratës publike në nivel të shteteve anëtare të BE-së dallon nga njëri tjetri. Parimet e *acquis* së BE-së për shërbyesit civil të institucioneve të BE-së janë të përcaktuara në *Rregulloren Nr. 31 (KEE) për Stafit të Zyrtarëve dhe Kushtet e Punësimit të Nëpunësve të tjerë të Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike (version i konsoliduar dhe aktet tjera përcjellëse)*.¹² Ndërsa, për shërbyesit civil të administratës publike në nivel të shteteve anëtare të BE-së, praktika gjyqësore e GJDBE-së ka mëshiruar parime të përgjithshme.¹³ Fushëveprimi i rregullimit të administratës publike, po ashtu edhe i pagave, në nivel të shteteve anëtare të BE-së dallon nga njëri tjetri.¹⁴

Acquis sekondar parashih gjithashtu dispozita që krijon një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion, dhe zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në fushën e punësimit dhe të profesionit.¹⁵ Dispozitat që rrjedhin nga *acquis* sekondare për këtë fushë tashmë janë të transpozuar në Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.¹⁶

Kërkesat për një administratë publike profesionale, efëcente dhe llogaridhënëse në Kosovë, për zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit të bazuara në merita, transparencë dhe paanshmëri si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e karrierës

¹¹ *Shih* Case C- 439/ 11, *Ziegler*, EU:C:2013:513, para 155.

¹² Neni 1 Regulation No 31 (EEC), 11 (EAEC), laying down the Staff Regulations of Officials and the Conditions of Employment of Other Servants of the European Economic Community and the European Atomic Energy Community, e qasshme përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A01962R0031-20220101>.

¹³ Bazuar në nenin 267 të TFBE-së, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka juridiksion për interpretimin e traktateve, vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit Evropian. *Shih* gjithashtu dokumentin shoqëruar lidhur me fushëveprimin e rasteve gjyqësore dhe parimeve të përgjithshme për nëpunësit në sektorin publik dhe privat, COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT, *Free movement of workers in the public sector*, SEC(2010) 1609 final (Dec. 14, 2010), European Parliament, European Union Civil Service Law, *Briefing Note* (2011).

¹⁴ *Shih* European Commission, *A comparative overview of public administration characteristics and performance in EU28* (2018), European Parliament, *Regulating working conditions through EU directives-EU employment law outlook and challenges* (2019), DIA, *Study on the EU and its Member States mobilizing Public Sector Expertise for Development, Final Report* (2019), European Public Administration Network, *THE CIVIL SERVICE SYSTEM AT EUROPEAN LEVEL* (2020), European Union, *THE COMPARATIVE ANALYSIS OF THE AREAS OF THE CIVIL SERVICE ACT IN THE SELECTED EUROPEAN UNION COUNTRIES* (2021). Këto dokumente konsultative me komentet nga DDBE-DIE/ZKM janë përcjell paraprakisht tek propozuesi i projektligjit me datën 7 shtator 2022.

¹⁵ *Shih* neni 1, Direktiva e Këshillit 2000/78/KE e 27 nëntorit 2000 për vendosjen e një kornize të përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion, e qasshme përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32000L0078>. *Shih* gjithashtu neni 1 Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit, e qasshme përmes: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32006L0054>.

¹⁶ *Shih* neni 1 para. 2 Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Data e publikimit: 26.06.2015, Gazeta Zyrtare: 16/2015, i qasshëm përmes: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924#>.

në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në kuadër të administratës publike, janë të përcaktuara edhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në mes të Republikës së Kosovës dhe BE-së.¹⁷ Neni 120 i MSA-së, kërkon:

Neni 120

Administrata publike

Bashkëpunimi dhe dialogu do të synojnë mundësimin e zhvillimit të mëtejshëm të një administrate publike profesionale, efçente dhe llogaridhënëse në Kosovë, duke u bazuar në përpjekjet e ndërmarra për reforma në këtë fushë deri më tani, përfshirë reformat që ndërlidhen me procesin e decentralizimit dhe të krijimit të komunave të reja. Bashkëpunimi do të mbështes në veçanti sundimin e ligjit, funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore për të mirën e popullsisë së Kosovës në tërësi si dhe zhvillimin normal të marrëdhënieve mes BE-së dhe Kosovës.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqendrohet kryesisht në ndërtimin e institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit të bazuara në merita, transparencë dhe paanshmëri si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në kuadër të administratës publike. Bashkëpunimi do të përfshij gjithashtu përmirësimin e efikasitetit dhe kapacitetit të organeve të pavarura që shërbejnë për funksionimin e administratës publike dhe për një sistem efikas të kontrolleve dhe balancave.

7. PËRSHKRIMI DHE VLERËSIMI I DOKUMENTEVE TË DËRGUARA ME LEGJISLACIONIN E PROPOZUAR NGA MINISTRIA E LINJËS

Fushëveprimi i rregullimit të administratës publike dhe marrëdhëniet e punës në shërbimin publik në Shtetet Anëtare të BE-së të përcaktuara në akte ligjore, nënligjore ose administrative, dallojnë nga njëri shtet në shtetin tjetër. Në aspektin përmbajtësor, *Projektligji për Zyrтарët Publik* synon përcaktimin e rregullave dhe parimeve bazike për pranimin, klasifikimin e pozitave, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës në institucionet publike të Republikës së Kosovës.¹⁸ Rekomandohet që përgjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm dhe nxjerrjes së legjislacionit sekondar, të merren për bazë parimet e përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion, dhe zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në fushën e punësimit dhe të profesionit, dhe e drejta e miradministrimit përgjatë procedurave për pranimin, klasifikimin e pozitave, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës në institucionet publike të Republikës së Kosovës.¹⁹

¹⁷ Ligji Nr. 05/L-069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërin anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, Data e publikimit: 01.12.2015, Gazeta Zyrtare: 34/2015, i qasshëm përmes: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11239>.

¹⁸ Neni 1 i *Projektligjit për Zyrтарët Publik*.

¹⁹ Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, *Neni 30* Mbrojtja në rast pushimi të pajustificuar nga puna "Çdo punonjës ka të drejtën e mbrojtjes kundër pushimit të pajustificuar nga puna, në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe praktikat dhe ligjet kombëtare." Shih *Neni 31* Kushte pune të ndershme dhe të drejta "1. Çdo punonjës ka të drejtën e kushteve të punës që respektojnë shëndetin, sigurinë dhe dinjitetin e tij ose të saj. 2. Çdo punonjës ka të drejtën për kufizimin e kohëzgjatjes maksimale të punës, për pushim ditor dhe javor si edhe për leje vjetore të paguar."

8. OPINIONI PËR PËRPUTHSHMËRINË


Ky opinion për përputhshmërinë me *acquis* është bazuar në përmbajtjen e projekt udhëzimit. Përgjegjësia e Divizionit të së Drejtës së BE-së vihet në dukje me opinionin e saj, ndërsa organi propozues (MPB), është përgjegjës të plotësojë Deklaratën e Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP) atëherë kur Projekt akti ndërlidhet me transpozim të *acquis* së BE-së. Institucionet e linjës janë përgjegjëse për politikën që ato bëjnë dhe për shkallën e harmonizimit me *acquis* të BE-së. Prandaj, periudhat paraprake nga transpozimi i pjesshëm deri në transpozim të plotë janë përgjegjësi e organit propozues të projekt aktit. Paraprakisht, plotësimi dhe përcaktimi i nivelit të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së, është përgjegjësi e institucioneve të linjës.

9. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Fushëveprimi i rregullimit të administratës publike dhe marrëdhëniet e punës në shërbimin publik në Shtetet Anëtare të BE-së të përcaktuara në akte ligjore, nënligjore ose administrative, dallojnë nga njëri shtet në shtetin tjetër. Rekomandohet që përgjatë shqyrtimit të mëtutjeshëm të *Projektligjit për Zyrarët Publik* dhe nxjerrjes së legjislacionit sekondar, të merren për bazë parimet e përgjithshme për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion, dhe zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë në fushën e punësimin dhe të profesionit, dhe e drejta e miradministrimit përgjatë procedurave për pranimin, klasifikimin e pozitive, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës në institucionet publike të Republikës së Kosovës.

Me respekt,

Labinote Kashtanjeva


Zv. Udhëheqëse e Divizionit për
Çështje Ligjore të BE-së
Divizioni për të Drejtën e BE-së
Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit